

Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “ Shërbime tek te tretet per automjetet dhe mjetet e tonazhit te rende(eskavator,furgona,pick up dhe autovetura) ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime dhe riparime dhe mirembajtjen e automjeteve dhe pajisjeve te lidhura.

Vlera e fondit limit : 10.000.000 (dhjete milion) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht në vlerën 200.000 (dyqind mije).leke*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Bazuar në pikën 3 neni 45 të VKM 285 datë 19.05.2021 ku autoriteti mund te mbeshtetet ne oferten ekonomikisht me te favorshme te bazuar ne çmim.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006

për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

4.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licënsuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1 »Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove sipas shërbimeve të kërkuara nga AK.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike licensën lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 gërma “a” të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik,i ndryshuar Kreu III,Seksioni II,Neni 41 pika 4 germa (a)

Argumentim teknik i kriterit:

Ky kriter është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim garantimin që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të jenë subjekte të licencuara ligjërisht dhe të autorizuar për të kryer shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve rrugore objekt procedure. Licenca e lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, provon kapacitetin profesional dhe ushtrimin e ligjshëm të aktivitetit ekonomik në fushën përkatëse.

Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me shërbime me të tretë për automjetet e Autoritetit Kontraktor, përfshirë mirëmbajtjen, diagnostikimin dhe riparimet e ndryshme mekanike, elektrike apo xhenerike, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë licencën përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të garantohet cilësia, siguria dhe përputhshmëria teknike e shërbimeve të ofruara.

Ky kriter është në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe objektin e prokurimit, nuk krijon kufizim të konkurrencës dhe i shërben verifikimit të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për realizimin korrekt të kontratës.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike certifikatat e mëposhtme:

5.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO TS 16949:2009 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 45001-2018 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

a) Certifikata ISO TS 16949:2009 (ose ekuivalente)

Kërkesa për paraqitjen e Certifikatës së menaxhimit të cilësisë ISO TS 16949:2009 (ose ekuivalente) është vendosur me qëllim garantimin e standardeve të cilësisë në ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve objekt kontrate. Ky standard lidhet me sistemin e menaxhimit të cilësisë në sektorin automobilistik dhe siguron që operatori ekonomik zbaton procedura teknike dhe organizative të kontrollit të cilësisë gjatë realizimit të shërbimeve.

Duke qenë se objekti i procedurës lidhet me shërbime për automjete, Autoriteti Kontraktor vlerëson të domosdoshme që operatorët ekonomikë të provojnë se operojnë sipas standardeve të njohura ndërkombëtare, me qëllim garantimin e sigurisë, funksionalitetit dhe jetëgjatësisë së mjeteve. Kjo kërkesë është në përpjesëtim me natyrën dhe rëndësinë e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi pranohet edhe certifikatë ekuivalente.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikimin për pjesën e shërbimit që merr përsipër sipas akt-marrëveshjes së bashkëpunimit, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve të kërkuara për secilin zë të kontratës.

b) Certifikata ISO 45001:2018 (ose ekuivalente)

Kërkesa për paraqitjen e Certifikatës ISO 45001:2018 (ose ekuivalente) është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik zbaton standarde të njohura ndërkombëtare për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë realizimit të shërbimeve objekt prokurimi.

Duke qenë se shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve përfshijnë procese teknike, përdorim pajisjesh mekanike dhe ndërhyrje që paraqesin risk operacional për personelin dhe ambientin e punës, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik të disponojë një sistem të certifikuar të menaxhimit të sigurisë në punë. Ky standard siguron minimizimin e rreziqeve, respektimin e kushteve të sigurisë teknike dhe mbrojtjen e punonjësve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Kriteri është në përputhje me natyrën e shërbimeve të kërkuara dhe proporcional me objektin e kontratës. Pranimi i certifikatave ekuivalente garanton respektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe nxit konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar ne funksion te realizimit shërbimit te kerkuar minimumi jo me pak se 5(pesë) punonjes, nga të cilët:

1 (një) inxhinier mekanik

1 (një) motorrist,

1 (një) mekanik

1(një) xhenerik,

1 (një) elektroaut

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

-Për inxhinierin mekanik operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën përkatëse, kontratën e punës e cila duhet të jetë e vlefshme.

-Për personelin tjetër teknik (xhenerik, motorist, elektroauto, mekanik) te paraqiten deshmitë të kualifikimit / ose te formimit profesional si dhe kontratat e punës të vlefshme.

a)Listë pagesat e punonjësve të plotësuar rregullisht sipas formatit e përcaktimeve që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

b)Vërtetimin për numrin e punonjësve të siguruar per muajin e fundit të lëshuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Argumentim teknik i kriterit:

Kriteri për disponimin e stafit teknik me jo më pak se 5 (pesë) punonjës është vendosur nga Autoriteti Kontraktor për të garantuar realizimin korrekt, cilësor dhe në kohë të shërbimeve objekt prokurimi, të cilat lidhen me mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve.

Duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve të kërkuara, të cilat përfshijnë diagnostikim, riparime mekanike, motorike, elektrike dhe elektronike të automjeteve, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë personel teknik të kualifikuar sipas profileve përkatëse profesionale, konkretisht:

- 1 (një) inxhinier mekanik, për mbikëqyrjen teknike, diagnostikimin dhe koordinimin e proceseve të riparimit;
- 1 (një) motorrist, për ndërhyrjet dhe riparimet e sistemeve motorike;
- 1 (një) mekanik, për mirëmbajtjen dhe riparimet mekanike të automjeteve;
- 1 (një) xhenerik, për riparimet elektrike dhe sistemet e ndezjes/gjenerimit;
- 1 (një) elektroaut, për diagnostikimin dhe riparimin e sistemeve elektronike dhe elektrike të automjeteve.

Ky staf konsiderohet minimal dhe i nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit, përballimin e volumit të punës dhe realizimin e të gjitha ndërhyrjeve teknike sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Kriteri është në përpjesëtim të drejtë me objektin dhe kompleksitetin e kontratës dhe nuk krijon kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi kërkon vetëm kapacitetet minimale profesionale të domosdoshme për realizimin e kontratës.

7. Drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ofertues (servis automjeteve) duhet të jetë inxhinier mekanik si dhe i punësuar me kohë të plotë i cili duhet të disponojë kualifikimet e mëposhtme:

-Diplomën përkatëse

-Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) te veprimtarisë së auto riparimit (referuar Ligjit Nr.9573, dt.03/07/2006) “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar.

Për të dëshmuar përmbushjen e kushtit të kërkuar më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën përkatëse si dhe Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) te veprimtarisë së auto riparimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, në pronësi ose me qera, ambientin për ushtrimin e aktivitetit servis automjeteve, në Tiranë, të pajisur minimalisht me repartet dhe pajisjet teknike bashkohore, të nevojshme për realizimin e zerave të riparimit të parashikuar nga AK, si më poshtë:

-**Repartit Elektroauto:** pajisje bango prove për motorrinë dhe dynamo, pajisje diagnostifikuese të difektit në automjet , pajisje të lëvizshme portabile për ndezje emergjente të mjetit, pajisje për kontrollin dhe komprimin e gazit të A/C,1.

-**Repartit motorist-** pajisje urë ngritëse për automjetet (me kapacitet jo më pak se 4 ton), pajisje për vënien në fazë së motorit, pajisje për retifikimin e testatës së automjeteve , pajisje për kontrollin e bllokut të cilindrit të motorit dhe testatove (për carje) , pajisje për riparimin e pompave dhe injektorëve.

Repartit Xhenerik/Mekanik: pajisje urë ngritëse për automjete(me kapacitet jo më pak se 4 ton) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit, pajisje për kontrollin dhe testimin e gazrave të automjetit , pajisje për sistemin e kontrollit dhe dedektimit të rrjedhjes së sistemit të ftohjes të automjetit (radiatorit dhe pjesëve të përbërëse të tij)

Në përmbushje të kriterit të kërkuar mbi disponimin e ambientit në rast pronësie operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e pronësisë ndërsa në rast qeraje duhet të paraqesë

kontratën e qerasë me qiradhënësin si dhe certifikatën e pronësisë së qeradhënësit, ose cdo lloj forme e parashikuar nga Kodi Civil i Republikës të Shqipërisë.

Vendodhja e servisit ku ushtron aktivitetin (Tiranë), duhet te jete e pasqyruar ne Ekstraktin Historik të rregjistrimit të të dhenave të subjektit.

-Për pajisjet në pronësi të paraqesë faturat e blerjes ose vërtetim zhdoganimi të blerjes së pajisjeve /ose / çdo lloj forme e parashikuar nga Kodi i Civil i Republikës së Shqipërisë.

-Për pajisjet e marrjes me qera duhet të paraqitet kontrata e marrjes me qera e shoqëruar me dokumentat e pasjes në pronësi të qeradhënësit ose cdo lloj forme e parashikuar nga Kodi i Civil Republikës së Shqipërisë.

Shënim: Për piken 6.7.8 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar mbështetur në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 77, si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.202021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik,i ndryshuar, Kreu III,Seksioni II,Neni 41 pika 4, si dhe Nr.9573, dt.03/07/2006) “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimn e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, të ndryshuar, si dhe natyrës së shërbimit të kërkuar.

9. Operatori ekonomik duhet te paraqesi ne sistemin elektronik nje deklarate me ane te seciles deklarone se ambjentet e servisit jane te pajisura me kamera sigurie të cilat bëjnë monitorimin 24 orë të gjithë veprimtarinë e riparimit të automjeteve si dhe në ambjentet e parkimit gjatë qëndrimit të tyre,gjithashtu duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike foto të ambjentit.

Shënim: Për piken 9 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur pasi garanton dhe krijon siguri Autoritetit Kontraktor se ambjenti i kontraktuesit është i sigurtë, i monitoruar gjatë kohës së kryerjes së shërbimeve për automjetet .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.
